



RREGULLORE

MBI MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SIGURIMIN FIZIK

PRISHTINË, Prill 2010

Në bazë të dispozitës së nenit 58 alineja 58.2, nenin 10 alineja 10.1 e lidhur më dispozitën e nenit 9 të Ligjit Nr. 02/L-41 për Mbrojtjen nga Zjarri të Republikë Kosovës, dispozitave adekuate të Statutit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, Pronari i këtij subjekti ekonomik të Arsimit të Lartë Privat, më datën **23/04/2010**, nxori këtë:

RREGULLORE

MBI MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SIGURIMIN FIZIK

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Për pengimin dhje mënjanimin e pasojave të rrezikut nga zjarri dhe për shpëtimin e punonjësve dhe të mirave materiale (*pasurisë*), të Universitetit për Biznes dhe Teknologji "UBT-e" - Prishtinë (**tani e tutje shkurt: UBT-e**), organizon dhe siguron mbrojtjen nga zjarri dhe sigurimin fizik të pasurisë dhe punonjësve në përputhje më ligjin, aktet rëndësore dhe Statutin e Shoqërisë.

Neni 2.

Mbrojtja nga zjarri i pasurisë dhe punonjësve si dhe sigurimi fizik i objekteve dhe pasurisë vendosur brenda dhe jashtë tyre, përfshin një varg masash dhe aktivitateteve të natyrës organizative, teknike, arsimuese dhe propaganduese që ndërmarrën në Shoqëri, më qëllim të pengimit dhe ndalimit të ndodhisë së zjarrit, të shpëtimit të njerëzve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri, si dhe të mbrojtjes, të ruajtjes dhe të pengimit të çfarëdo forme të tjetërsimit të pasurisë.

Neni 3.

Të gjithë punonjësit e UBT-se, kanë për detyrë që të përkujdesen për ndërmarrjen e të gjitha masave të mbrojtjes nga zjarri në përputhje më ligjin, këtë Rregullore si dhe Planit për mbrojtje nga zjarri.

II. MASAT E MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 4.

Si formë e masës mbrojtëse nga zjarri, në pajtim më dispozitën e nenit 3 të kësaj Rregulloreje, janë:

- zgjedhja e lokacionit dhe e pjesëve të objektit (*sallave, zyrave, arkivit etj.*) ku do të pengohet dhe/apo mundësia e shpërthimit të zjarrit dhe zgjerimit të tij do të sillet në masën më të vogël të mundshme,
- lënia e lirë e rrugëve hyrëse dhe dalëse për lëvizje pa pengesa të pajisjeve dhe njerëzve,
- sigurimi i hidrantëve dhe/apo sasive të nevojshme të ujit dhe mjeteve dhe pajisjeve tjera (aparateve) për fikjen e zjarrit,
- ndalimin e përdorimit të ndezjes së zjarrit të hapur dhe burimeve tjera ndezëse në objekte më të cilat mund të shkaktohet zjarri,
- vendosja në vende përkatëse të pajisjeve (*aparateve*) si dhe e instalimeve për fikjen e zjarrit.

III. PLANI PËR FIKJEN E ZJARRIT

Neni 5.

Organizimi dhe zbatimi i masave të mbrojtjes nga zjarri bëhet në bazë të planit përkatës për mbrojtje nga zjarri, plan ky i cili nxirret në nivel të UBT-se si tërësi.

Neni 6.

Plani i mbrojtjes nga zjarri përfshinë sidomos:

- vlerësimin e rrezikshmërisë nga zjarri së bashku më analizën e ngarkesave nga zjarri,
- organizimin e mbrojtjes nga zjarri,
- mënyrën e përdorimit të pajisjeve dhe aparateve për fikjen e zjarrit,
- sistemin e informimit,
- mënyra e furnizimit më ujë,
- përcaktimin e rrugëve për hyrje & dalje,

- ndalimin e përdorimit të zjarrit të hapur dhe të burimeve tjera ndezëse,
- mënyrën e shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë, si dhe
- kërkimin e ndihmës për veprim të njësive profesionale të zjarrfikësve, ndihmës së parë dhe policisë.

Neni 7.

Organizimi dhe zbatimi i mbrojtjes nga zjarri bëhet në bazë të planeve të mbrojtjes nga zjarri, që nxirren në nivel të UBT-se.

Neni 8.

Planet e mbrojtjes nga zjarri përfshijnë sidomos:

- vlerësimin e rrezikshmërisë nga zjarri më analizën e ngarkesave nga rrezikshmëria e zjarrit,
- organizimin e mbrojtjes nga zjarri,
- mënyrën e përdorimit të pajisjeve dhe aparateve për fikjen e zjarrit,
- sistemin e informimit për punonjësit dhe njësitet profesionale të zjarrfikësve,
- mënyrën e furnizimit më ujë për fikje të zjarrit,
- kalesat dhe rrugët hyrëse dhe dalëse,
- ndalimin e përdorimit të zjarrit të hapur si dhe të burimeve tjera ndezëse,
- ndërmarrjen e masave për shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë,
- ndërmarrjen e masave tjera të nevojshme për funksionimin e suksesshëm të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 9.

Puna në lokalet afariste dhe objektet tjera të UBT-se, duhet organizuar në atë mënyrë që rreziku nga ndezja të jetë i evitueshëm, respektivisht të sjellët në parametra të tillë sa që rreziku nga ndezja e zjarrit të jetë në masën sa më të vogël.

Në të gjitha hapësirat dhe lokalet ku rreziku për ndezje është i mundshëm, si preventivë duhet venë në vende të posaçme pajisjet dhe aparatet për fikjen e zjarrit.

Neni 10.

Instalimi elektrik, ventilimi për ftohje apo ngrohje dhe të tjera, duhet vendosur sipas normativave si dhe standardeve përkatëse dhe ligjit.

Materialet ndezëse mund të mbahen dhe magazinohen vetëm në vende të përshtatshme, të rregulluara në përputhje më normativat dhe standardet gjegjëse.

Neni 11.

“UBT-e” është e obligueshme që pajisjet dhe aparatet për fikjen e zjarrit ti mbaj në gjendje të rregullt, dhe ato duhet vendosur në vendet e dukshme dhe të përshtatshme për përdorim.

Neni 12.

Pajisjet dhe aparatet për fikjen e zjarrit mund të përdoren vetëm nëse ato u përgjigjnë standardeve përkatëse, si dhe kritereve dhe kushteve paraparë më **dispozitën e nenit 20** të **Ligjit për Mbrojtjen nga Zjarri**.

Pajisjet dhe aparatet për fikjen e zjarrit duhet të kenë të vendosura kartelat e posaçme, në të cilat shënohet sidomos:

- lloji i pajisjes gjegjësisht aparatit,
- numri fabrikues,
- data e plotësimit dhe data e kontrollit të fundit, si dhe
- nënshkrimi i personit të autorizuar që e ka plotësuar dhe vula.

IV. SIGURIMI FIZIK I PASURISË

Neni 13.

Pas përfundimit të orarit të punës, punonjësit janë të obliguar që të bëjnë shkyçjen e të gjitha aparatave për ngrohje dhe aparatave tjera elektrike – si preventiv e rrezikut për ndezje nga zjarri.

Neni 14.

Më sigurimin e pasurisë nënkupton ruajtja e të gjitha gjësendeve, siç janë: ndërtesa, pajisjet, instalimet, ambalazhi, mobilet, mjetet e transportit dhe sendet tjera të luajtshme apo të paluajtshme, pasuri kjo e cila mund të prishet apo tjetërsohet nga individ ose grupe të caktuara jashtë autorizimeve dhe dëshirës së pronarit të UBT-se.

Sigurimi fizik i pasurisë bëhet përmes punësimit të numër të caktuar të punonjësve roje dhe zjarrfikës të trajnuar ose angazhimit të punonjësve profesionist nga ndonjë kompani e licencuar, si dhe kryerjes së kontrollit të herëpashershëm nga punëdhënësi dhe personat e autorizuar nga ai.

Neni 15.

Punonjës në punët e rojës respektivisht zjarrfikësit nuk mund të angazhohet punonjësi i cili:

- eshtë i dënuar për kryerjen e veprave penale, çfarëdo vepre penale qoftë ajo,
- nuk ka të kryer më së paku shkollën e mesme dhe të mos jetë më i vjetër së 35 vjet,
- në pikëpamje psikike dhe fizike nuk eshtë i afet për kryerjen e punëve të rojës respektivisht zjarrfikësit, aftësi psikike dhe fizike këto që detyrimisht duhet dëshmuar më aktdëshmi të posaçme lëshuar nga institucioni gjegjës, si dhe
- punonjësi i cili nuk eshtë i aftësuar në pikëpamje profesionale për shuarje të zjarrit dhe shpëtim.

Neni 16.

Punonjësi roje që kanë për detyrë sigurimin e pasurisë, kanë sidomos këto autorizime:

- të ndal dhe legjитimoj personat e paautorizuar që gjendën në lokalet e UBT-se,
- të ndaloj personat e zënë në kryerjen e veprave penale të vjedhjeve dhe të ngjashme,
- të lajmëroj menjëherë personin përgjegjës, policinë apo njësitin e zjarrfikësve.

Neni 17.

Punonjësit e UBT-se, secili në kuadër të fushëveprimit të tyre, janë përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e mbrojtjes nga zjarri dhe sigurimin e pasurisë.

Neni 18.

Secili punonjës i cili heton rrezikun e drejtpërdrejt për shpërthimin e zjarrit, ka për detyrë që të evitoj shkakun e tij, respektivisht të fikë zjarrin, nëse një gjë të tillë mund t'a bëjë pa rrezikuar vetën dhe jetën e punonjësve tjerë, në përputhje të plotë më dispozitën e **nenit 36** të Ligjit për **Mbrojtjen nga Zjarri**.

Nëse punonjësi nuk mund t'a evitoj rrezikun nga shpërthimi i zjarrit, ka për detyrë që lidhur më këtë të njoftoj punonjësin përgjegjës, policinë dhe njësitin e zjarrfikësve.

Neni 19.

Përveç obligimeve përshkruar nga neni paraprak i kësaj rregulloreje, punonjësit kanë për detyrë që të ndërmarrin masa të nevojshme për mbrojtje nga zjarri, si në vijim:

- tu përbahet rregullave dhe masave për mbrojtje nga zjarri paraparë më ligj dhe këtë rregullore,
- gjatë kohëzgjatjes së punës përherë të perfeksionojë njohuritë e veta nga fusha e mbrojtjes nga zjarri, të marrë pjesë në agjenda dhe kurse lidhur më mbrojtjen nga zjarri dhe sigurimin e pasurisë dhe njerëzve,
- të shërbehet më pajisjet dhe aparatet për fikjen e zjarrit, dhe këto pajisje ti përdori rreptësisht vetëm sipas destinimeve të tyre,
- të njoftoj punonjësin përgjegjës për të gjitha prishjet, mungesat, rreziqet dhe burimet e zjarrit, si dhe mbi dukuritë tjera që mund të shkaktojnë zjarr,
- pas përfundimit të orarit të punës të shikoj mirë rreth vendit të tij të punës, të shkyç aparatet elektrike dhe dritat, si dhe të heqë tërë materialin që mund të shkaktoj ndezjen nga zjarri,
- të kujdeset mbi pastrimin e të gjitha rrugëve të hyrjes apo daljes, të dedikuara për largim të punonjësve apo mallit në rast rreziku nga zjarri, dhe qasje të njësive të zjarrfikësve më pajisjet e tyre,
- të marr pjesë në aksionin për shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë të rrezikuar nga zjarri, si dhe atyre tu ofroj ndihmën e parë, si dhe
- të kryej edhe punë e veprime tjera paraparë më ligje si dhe këtë rregullore.

Neni 20.

Punonjësi i cili në kuadër të fushëveprimit të punëve dhe detyrave të tij të punës, nuk i kryen punët e caktuara lidhur më mbrojtjen nga zjarri si dhe sigurimin e pasurisë të UBT-se përgjithësisht, në përputhje më ligjin dhe këtë rregullore, bënë shkeljen e detyrave të punës.

Neni 21.

Më rastin e punësimit të punonjësit ose caktimit të tij në punë dhe detyra tjera të punës, punonjësi duhet njoftuar më rreziqet nga zjarri dhe ndërmarrjen e masave adekuate për fikjen e zjarrit, si dhe të njoftohet kundrejt përgjegjësive që ka në rast të mosveprimit për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga zjarri.

Lidhur më njohjen e punonjësit më rrezikun nga zjarri dhe ndërmarrjen e masave mbrojtëse dhe preventive si dhe masave për fikjen e zjarrit, mbahet evidencë e posaçme.

Neni 22.

Planet mbrojtje nga zjarri duhet nxjerrë në afate optimale, dhe më së voni gjashtë (6) muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23.

Çdo gjë që nuk është paraparë më këtë rregullore, aplikohen dispozitat gjegjëse të **Ligjit mbi Mbrojtjen nga Zjarri**.

Neni 24.

Ndryshim plotësimet e kësaj rregulloreje behën në procedurë të njëjtë, e cila vlen për nxjerrjen respektivisht miratimin e sajë.

Neni 25.

Rregullorja hynë në fuqi menjëherë, dhe atë që nga momenti i nxjerrjes të së njëjtës respektivisht që nga data **23.04.2010**.

PRISHTINË,

Datë, 23/04/2010

Presidenti i UBT-së,

Prof. Dr. Edmond Hajrizi

